

VENDIM
Nr.11, datë 2.3.2009

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “TERMOCENTRALI VLORË“ SHA PËR
KRYERJEN E AKTIVITETIT TË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13 pika 1, germa a, dhe 15 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, neneve 5, germa a, 13 dhe 14 pika 1, të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.2.2009, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë Termocentrali Vlorë sh.a. dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi licencimin e shoqërisë e Termocentrali Vlorë sh.a. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

Dhe konstatoi se:

- Aplikimi plotëson përgjithësisht kërkesat e ERE-s, lidhur me licencimet në sektorin e energjisë elektrike.

- Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- kryerjen e pagesës së regjistrimit të aplikimit për licencë pranë ERE-s (neni 9, pika 3, germa d),

Është i lidhur me arsye objektive që dalin jashtë mundësive të kompanisë për ta paraqitur atë brenda afatit të shqyrtimit të aplikimit në ERE, si dhe me çeljen e fondit përkatës nga KESH sh.a.

- Licencimi i kësaj shoqërie lidhet ngushtë me kryerjen e një investimi publik përmes ngritjes së termocentralit në zonën e Vlorës dhe përbën një nga investimet më të mëdha për sektorin elektroenergjetik, i kryer me kontributin e përbashkët të Bankës Botërore, BERZh, BEI, marrëveshje këto të ratifikuara nga Kuvendi.

Për gjitha sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë Termocentrali Vlorë sh.a. për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike për një afat 30 vjet.

2. Shoqëria Termocentrali Vlorë sh.a. të kryejë pagesën e regjistrimit të aplikimit për licencë menjëherë me çeljen e fondit për këtë pagesë nga KESH sh.a.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta